ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-4754-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Donjeta Gashi Hamzaj B.I.**
NUI	**810941171**
Adresa	**Rr.Leke Dukagjini Obj. 6/6 hyr 1 Nr.6**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10 000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Donjeta Gashi**
Adresa elektronike	**gashi.donjeta@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues - 14.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kam dorëzuar kërkesë për rishqyrtim më 19.06.2024 e cila është refuzuar më 20.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 56 - Ligji i Prokurimit Publik
Neni 69 - LPP
A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
A02 Udhezues Nr-001/2023 per prokurimin publik?

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Përmbledhje faktike dhe procedurale:

Me 31 maj 2024 ne cilësinë e operatorit ekonomik Donjeta Gashi Hamzaj, B.I kam aplikuar ne tenderin e cituar si me larte. Ne kuadër te dosjes time te tenderit kam bashkangjitur gjithë dokumentet relevante te specifikuara nga AK. Nga data 31.05.2024 kur është bere hapja e ofertave ku unë kam rezultuar operatori me çmimin me te ulet deri te njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues te datës 14.06.2024 kishte kaluar afërsisht 2 jave dhe AK ne asnjë faze te procedurës nuk me ka kontaktuar me shkrim për ndonjë për ndonjë sqarim të ndonjë dokument qe LPP ose udhëzuesi nr.001/2023 I prokurimit publik lejojnë qe AK te kërkojnë informata shtese nga OE. Sidoqoftë kjo nuk ka ndodhur edhe pse ne cilësinë e OE jam e bindur qe gjithë dokumentet e kërkuara ne dosjen e tenderit te njëjtat janë pjese e dosjes time e për te cilën nuk kam ndonjë arsye se perse AK ka vendosur ndryshe. II.

Pretendimet ankimore:

E para, konsideroj se kjo ankesë do shërbejë si precedent i mire për rastet si ky dhe ato te ngjashme qe mund te dalin ne te ardhmen sesi autoritetet publike duhet te jene ne nivel te detyrës dhe në zbatim te ligjit, ruajtjes se fondeve publike etj., ne rastet kur vendosin për operatoret ekonomik te përgjegjshëm dhe te cilët i përmbushin kriteret publike qe vet autoritetet publike i vendosin si te tilla. Tani me lejoni ti argumentoj shkeljet ligjore te cilat AK i ka bere me rastin e njoftimit te cilin tashme po e kontestoj. I. Si arsye të parë të eliminimit AK pretendon se unë kam ofertuar me çmimin jo normalisht te ulet. Me lejoni qe te ju njoftoje se ky konstatim është absolutisht i pa sakte kjo për faktin se kriteri kryesore ne këtë tender ka qene çmimi me i ulet, rrjedhimisht oferta ime ka qene ne vlerën prej 15,650 euro. AK ka bërë shkelje ligjore pasi nuk ka ndjekur fare procedurat për trajtimin e një ofertë si tender jo normalisht të ulët në përputhje me nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2002 e cila thotë: 41.6 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët". Pra përveç që AK nuk ka ndjekur procedurën dhe nuk ka kërkuar sqarime nga unë, nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse çmimi është

dukur si jo normalisht i ulët. Neni 41.2 i Rregullores e ndalon AK që të bëjë përjashtim automatik të operatorit ekonomik i cili sipas AK duket që ka tender jo normalisht të ulët:

41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes *me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. 3/5F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK Prandaj kjo arsye e eliminimit nuk qëndron pasi nuk ka bazë ligjore. Për më tepër çmimi i ofertës time as nuk konsiderohet si jo normalisht i ulët në bazë të formulës për trajtimin e tenderëve jo normalisht të ulët. (Neni 41.3 i Rregullores.*

Prandaj kjo arsye e eliminimit nuk qëndron pasi nuk ka bazë ligjore. Për më tepër çmimi i ofertës time as nuk konsiderohet si jo normalisht i ulët në bazë të formulës për trajtimin e tenderëve jo normalisht të ulët. (Neni 41.3 i Rregullores). AK pretendon së është plotësuar kushti prej 30%, por edhe në këtë përgjigje AK shihet që nuk ka njohuri të rregullave të prokurimit, pasi kërkohen që të jenë tri oferta të përgjegjshme për tu plotësuar ky kusht. Gjithashtu është detyrë ligjore e AK të kërkojë sqarime, e pastaj ne do të pergjigjeshim. AK nuk mund të argumentojë fare se pse cmimi ju duket si jonormalisht i ulet.

Se dyti, ne arsyetimin e eliminimit specifikohet se OE nuk i ka dorëzuar deklaratat e dorëzuara ne ATK te cilat dëshmojnë qarkullimin e kërkuar. OE konstaton se janë dorëzuar kontratat e realizuara me herët ku dëshmohet qe OE ka pas marrëdhënie kontraktuale prokurimi me sektor publik dhe privat si lloj dëshmie për qarkullimin e kërkuar etj. Megjithatë, edhe pse dëshmi tjera për qarkullim financiar nuk janë dorëzuar, AK ka mundur të kërkojë sqarime për këto sipas nenit 66, 68 dhe 69 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik 001/2023, ku thuhet se nëse:

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkohen informata sqaruese	6

Prandaj duke marrë parasysh se çmimi I ofertës time është për 13,850 euro më I lirë se I ofertës së OE të rekomanduar, AK është dashur ta ketë parasysh këtë gjatë vlerësimit të ofertave.

Se treti, ne njoftimin për vendim specifikohet se mungon lista e pajisjeve. Edhe kjo është tërësisht e pa saktë. Ju lutem referojuni dokumentit 5 Specifikat Teknike-pajisjet.pdf, faqes 3 ku ne mënyrë detaje argumentohet se me cilat pajisje planifikoje qe te përmbushi detyrat në tërësi.

PAJISJET

D Creative do të sigurojë pajisjet e teknologjisë më të lartë për
dhe do të punojë me kapacitete të plota për të arritur afatin ko
projektit.

Redaktimi, ngjyrat dhe efektet anësore të nevojshme në punën
bëhen me teknikën - Intel Core i9-10900K 10Bortha / 20Thr
Cache, CoolerMaster MasterLiquid MLR360 RGB.

Për kualitetin e videove dhe animacioneve që kemi punuar ndër
të shihni edhe portofolion e kompanisë të bashkangjitur në këtë

AK nuk ka specifikuar se me çfarë pajisje duhet të ofertohet, dhe nëse ka pasur dilema është dashur të kërkojë sqarime me qellim te marrjes se informacioneve shtese përkitazi me tenderin ne fjale. Sipas LPP, neni 53, OE nuk mund të eliminohet për kërkesa që nuk kanë qenë në dosje të tenderit. AK nuk ka specifikuar fare se çfarë pajisje duhen, ndërsa ne i kryejmë detyrat tona me pajisjet e listuara në ofertë, dhe nëse ka nevojë për tjera ato sigurohen gjatë implementimit të kontratës.

Se katërti dhe e fundit, AK me rastin e njoftimit po ashtu konstaton se ne rastin tim mungon
lista e stafit.
Lista e stafit është dorëzuar në fajllin Specifika teknike, ndërsa CV e stafit janë dorëzuar ndaras me emër dhe mbiemër për secilin ofrues i cili do jete pjese e ofertës time. Nuk besoj
qe është e nevojshme te recitojë me emër te përveçëm secilin pjesëmarrës ne listën e stafit te cilën e kam dorëzuar nga menaxheri i projektit qe është Donjeta Gashi Hamzaj deri tek pjesëmarrësit tjerë emra te respektuar ne Kosove sa i përket mediave dhe marketingut ne vendin tone.

AK ka shpërblyer operatorin ekonomik me çmimin më të lartë duke dëmtuar buxhetin e saj dhe duke mos arritur vlerën për para sipas LPP. AK ka rekomanduar për kontratë, OE I cili është për 13,850 euro më I shtrenjtë, apo 88.50% më I lartë. Duke pas parasysh gjithë vrojtimet si me larte kerkojme nga OSHP te nxjerre kete vendim:

I. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 14 qershor 2024;

II.OBLIGOHET, AK qe te njoftoje Operatorin Ekonomik, Donjeta Gashi Hamzaj, Biznes Individual, Rr. ‘’Lekë Dukagjini’’ obj. 6/6, Hyrja 1, Nr. 6 Prishtinë – Republika e Kosovës, me njoftimin e ri për dhënien e kontratës si operator i përgjegjshëm dhe me çmimin me te ulet ekonomik konform DT te publikuar nga AK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*